

COLOREVIVO

BOJË ME BAZË UJI SUPER E LASHME PËR SIPËRFAQE TË BRENDSHME- MBULIM I LARTË-THARJE E SHPEJTË

Seri 361

PËRSHKRIMI

COLOREVIVO është bojë me bazë uji super e lashme, me bazë lidhësa në dispersion ujqor. Realizon finiturë me cilësi të lartë, opake dhe uniforme duke lejuar ngjyrimin në menyër të shpejtë. Performancë e lartë, bardhësi e lartë dhe fuqi maskuese e shkëlqyer, me mbulim të gjerë edhe në ngjyrat e errëta. Lejon të arrihet një rezultat i pastër dhe precis në aplikimin me rruel dhe pinel.

Pa aromë, me përmbajtje të ulët të përbërësve organikë të paqëndrueshëm, me garancinë për një jetesë komforte.

ISTRUKSIONE PËR PËRDORIM

E aplikueshme në:

- Suvatime të reja dhe të vjetra.
- Sipërfaqe betoni.
- Sipërfaqe gipsi dhe kartonxhesi.
- Bojra të vjetra dhe veshje me natyrë organike ose minerale, të thata, kompakte, absorbuese dhe kohezive.
- Sipërfaqe me natyrë minerale me kusht që të jene absorbuese..

Sipërfaqet përgatiten sipas shpjegimit në paragrafin "Përgatitja e sipërfaqes".

Mos aplikoni në sipërfaqe të freskëta (të sapo suvatuara) dhe me tendencë alkaline, prisni një kohë të përshtatshme maturimi (tharje) përgjithësisht 4 javë.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Cilësia e ajrit të brendshëm (Dekreti francez nr 2011-321 më 23 mars 2011): A+
- Natyra e lidhësit: Polimerë sintetikë të modifikuar në dispersion ujqor.
- Klasifikimi UNI EN 13300:
 - .Rezistenca në larje ISO 11998: klasi 2
 - .Shkëlqimi EN ISO 2813: <5, shumë opake
 - .Mbulimi ISO 6504-3: klasi 1 me një rreze prej 7 m2/l
- Karakteristika të tjera
 - Dendësia UNI EN ISO 2811-1: 1,55 ± 0,05 kg/l
 - Viskoziteti i paketimit UNI 8902: 30000 ± 3200 cps në 25 °C (viskozimetër rrotullues Brookfield)
 - Rezistenca në larje UNI 10560: >5000 cikle, e shkëlqyer
 - Tharja (në 25 °C dhe 65% të U.R.): prekja pas 30 minutash; shtresa tjetër pas 2 orësh.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqe murale:

- Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe e maturuar. Nëse është e nevojshme siguroni konsolidim me produkte specifike.
- Në prani të mykut trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes). Shtojini bojës, nëse është e nevojshme, higjienizuesin COMBAT 444 kod. 4810444.
- Hiqni, me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, mykun prezent dhe pluhurat e bojës së vjetër. Eliminoni shtresat e ngritura të bojës në gëlqere ose bojës transpirante/tempera.
- Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim.
- Niveloni parregullsitë e sipërfaqes dhe trajtoni trajtoni vrimat, çarjet me TAMSTUCCO. Mbyllni çarjet me ngjithës (stuko) të përshtatshëm.
- Zmeriloni çarjet e stukuara me letër zmerile.
- Kryeni zbutje në sipërfaqe me RASAMIX 9440160 ose me BETOMARC 9450150 ose me RASOMARC 9500150 në bazë të llojit të sipërfaqes.
- Aplikoni një shtresë IDROFIS 4700006 astar akrilik me bazë uji ose me astarin e mikronizuar solvent free ATOMO 8840001. Në kartonxhes aplikoni astarin specifik PREPARA 4710019 astar i pigmentosur. Në përgjithësi, në sipërfaqe me shumë pluhur, në prani të spesorëve të ulët të temperave të vjetra ose bojrave të degraduara, përdorni astarin me solvent ISOMARC 4410111 ose astarin e mikronizuar solvent free ATOMO 8840001.
- Vazhdoni me aplikimin e COLOREVIVO sipas metodave të përshkruara në udhëzimet për aplikim.

* (Hollimi i astarit dhe sasia për t'u aplikuar janë në funksion të absorbimit të sipërfaqes dhe përcaktohen me prova paraprake në sipërfaqe specifike. Konsultohuni me skedën teknike përkatëse).

UDHËZIME PËR APLIKIM

- Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:
 - Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C
 - Lagështira relative e ambientit: <75%
 - Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C
 - Lagështira e sipërfaqes: <10%
- Shmangni aplikimin në sipërfaqe që janë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të rrezeve të diellit.

COLOREVIVO

BOJË ME BAZË UJI SUPER E LASHME PËR SIPËRFAQE TË BRENDSHME- MBULIM I LARTË-THARJE E SHPEJTË

Seri 361

- Mjetet: rrul me qime leshi ose mikrofibra, pinel, airless.
- Nr. i shtresave: të paktën 2 shtresa.
- Holluesi: ujë
- Hollimi: me rrul 20-25%; me pinel 40-45%.
- Në aplikimet me airless hollimi varion në bazë të mjetit të përdorur dhe presionit të ushtruar.
- Pastrimi i mjeteve bëhet menjëherë pas përdorimit, me ujë.
- Shkalla e mbulimit: 10-14 m²/l per shtrese dhe l referohet aplikimit ne sipërfaqe lisho dhe mesatarisht absorbuese. Është mirë që të përcaktohet rrezja efektive me një provë paraprake në sipërfaqe specifike.

NGJYROSJA

Ngjyrosja mund të arrihet përmes sistemit tintometrik Marcromie dhe me kolorantët COLORADO seri 548.
VEMENDJE: për ngjyrat që derivojnë nga baza transparente këshillojme një hollim deri në maksimumi 20% me ujë.
Në rastin e përdorimit të prodhimëve të ndryshme, këshillohet përzjerja e tyre për të shmangur ndryshime të vogla në tonalitete.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30° C
Temperatura minimale e ruajtjes: +5 ° C
Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)
Cat. A/a: bojë opake për mure dhe tavane të brendshëm (shkëlqimi <25@60°) (bazë Uji): 30 g/l (2010)
COLOREVIVO Përmban max: 30 g/l VOC
Përdoreni produktin sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë pas përdorimit mos l hidhni mbetjet në ambient, l lini të thahen dhe l trajtoni ato si mbetje të vecanta. Mos l hidhni mbetjet/ambalazhet në kanalizime, terren.
Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

Bojë me bazë uji super e lashme, opake me mbulim të lartë, pa aromë, me përmbajtje të ulët

të përbërësve organikë të paqëndrueshëm, pa plastifikantë (pluhura), e shpejtë në tharje. Aplikimi, në sipërfaqe të predispozuar, për bojë uji COLOREVIVO seri 361 me bazë rezinë sintetikë të modifikuar në dispersion ujor, të paktën 2 shtresa, në sasinë e caktuar nga absorbimi l sipërfaqes.
Furnizimi dhe instalimi i materialit € për m².

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti l produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.